

MUHAMED MUTEVELI ESH-SHAËRAVI

MADHËSHTIA E ISLAMIT

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik

Sekreti i botës së padukshme

Zoti e krijoi botën, dhe gjithçka që ekziston në të (botë) ia nënshtroi njeriut, absolutisht vetëm njeriut, sepse Zoti është ai i cili e ka paraparë që njeriu të jetojë në të. Përdërisa Ai është i cili e ka paraparë, ka dashur që t'ia lehtësoj mjetet dhe elementet për jetesë dhe mbijetesë dhe siç e kemi thënë shumë herë se Ai është Mbikëqyrës dhe Mbrojtës, pra Zoti është Mbrojtës, Udhëheqës dhe Mbizotërues.

Kuptimi i fjalës Mbrojtës është: Ai i cili siguron mbrojtjen, dhe atij që është i mbrojtur ia përgatit nivelin më të lartë të arritjes së shpresave dhe qëllimeve. Për këtë arsye, Mëshira e Zotit është në atë se toka i përgjigjet njeriut për çdo gjë që dëshiron dhe ka nevojë. Ai i cili vepron me shkaqet, është po Ai i cili i ka paraparë ato shkaqe.

Pasi që Ai disponon dhe vepron me shkaqet, ka krijuar të shkaktuarën e këtyre shkaqeve për dy drejtime:

- drejtimin që t'i përgjigjen shkaqet Atij në këtë botë; dhe
- drejtimin e begative të Begatidhënësit (Zotit) për të begatuarin (njeriun) në botën tjetër.

Ai i cili përqendrohet dhe ndalet vetëm te shkaqet dhe refuzon të pranojë që janë të krijuara prej Shkaktuesit, atëherë shkaqet i japin atij (merr të mira të kësaj bote) aq sa jep mund dhe angazhim në ato shkaqe, ndërsa kur vdes (dhe shkon në botën tjetër), Zoti ia pasqyron çështjen duke thënë:

وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَعْمَلُهُمْ كَسَرَابٍ بِقِيعَةٍ يَحْسَبُهُ الظَّمْآنُ مَاءً حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُ لَمْ يَجِدْهُ شَيْئًا
وَوَجَدَ اللَّهَ عِنْدَهُ فَوَفَّاهُ حِسَابَهُ وَاللَّهُ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٣٩﴾

“Shembulli i atyre të cilët mohojnë Zotin e tyre, veprat e tyre janë sikurse paraqitja e mirazhit në një kodrinë dhe i eturi mendon dhe llogaritë se është me ujë.” (En Nurë : 39)

Pra, të vepruarit e tyre me shkaqet do të jep rezultate varësisht në bazë të veprimit të tyre me ato shkaqe.

(Në gjuhën arabe) Fjala “serab” (mirazh) është ajo që ty të imagjinohet deri sa je në shkretëtirë dhe ti mendon se ka ujë dhe kur të shkosh atje nuk gjen ujë. Kështu është çështja me ata të cilët mohojnë **“...Zotin e tyre, veprat e tyre janë sikurse “serabi” (mirazhi) në një kodrinë dhe i eturi mendon dhe llogaritë se është me ujë.”**, natyrisht se i eturi kur ta shoh “serabin” (mirazhin) shkon atje.

Shikoni mrekullinë e pasqyrimin: **“sikurse serabi (mirazhi) në një kodrinë dhe i eturi mendon se ka ujë”** dhe kur të shkon aty nuk gjen asgjë. Humbja e shpresës pas shpresës, dëshpërim pas dëshpërimi. Ai është i uritur dhe i etur, dhe po ashtu në shkretëtirë, pastaj nuk gjen ujë, e pas kësaj si të shpreson më tutje?.

Mirëpo ai ka harruar (se ka menduar) se etja e tij do të shuhet me shikimin e atij uji, mirëpo ai nuk ka gjetur asgjë. Do të ishte mirë po të përfundonte çështja vetëm tek ai zhgënjim dhe dëshpërim, mirëpo befasia tjetër është se ai pranë vetes do ta sheh Allahun. Ai befasohet edhe me shumë kur e gjen Allahun.

Kuptimi “është befasua me gjetjen (ekzistencën) e Allahut” është se: Ai çdoherë i është mbështetur vetëm shkaqeve të kësaj bote dhe në mendjen e tij as që ka menduar për Allahun dhe tani e sheh Allahun **“dhe jep llogarinë e tij”**. Përderisa kur ka vepruar diçka më parë as që e ka menduar Allahun (dhe llogarinë).

Zakonisht njeriu e merr shpërblimin prej atij te i cili ka punuar. Kurse ai i cili nuk ka punuar për Allah do të befasohet kur ta kupton se Ai i cili është pranë tij është Allahu, e ai nuk ka punuar për Të (Allah), e si t’i jep (Allahu) diçka?

Mirëpo, parashtrohet pyetja: A mos ja ka ndaluar Allahu shpërblimin e punës së tij të cilën e ka punuar në këtë botë për këtë botë? Jo! Atij i thuhet: Ti ke qenë i suksesshëm, ti ke qenë zbulues (shkencëtar) dhe ajo të përket ty, ti je lavdëruar, ti je dekoruar dhe e tërë bota (njerëzit) të ka respektuar, sepse ajo punë ka qenë për botën (njerëzimin) dhe nuk ka qenë për Allah. Dhe kjo botë i ka dhënë (të mira) atij për aq sa ka qenë në këtë botë, bile edhe në qoftë se ka qenë shkencëtarë, pasi të zhduket bota nuk ka kush që t’i jep asgjë, sepse në zemrën e tij nuk ka qenë Allahu.

Ata të cilët thonë: Ka pabesimtar të cilët i kanë dhënë njerëzimit këtë apo atë, atëherë si po u mohohet shpërblimi?. Ne u themi atyre: Ata nuk janë privuar nga shpërblimi. Bota u ka dhënë atyre atë për çka kanë punuar. Bota u ka dhënë çmime, dekorime, pasuri, etj.. Kanë punuar për njerëzimin dhe njerëzimi i ka shpërblyer. Për këtë arsye, atij i cili ka punua një punë dhe nuk shpërblehet, peygamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Do t’i thuhet atij: Ti ke vepruar, që të thuhet për ty se e ke bërë dhe veç është thënë. Dhe çështja ka përfunduar.”

Kështu pra:

- Ai i cili ka punuar për të përfunduarën (këtë botë), shpërblimi i tij është në të përfunduarën (këtë botë).

- Ai i cili ka punuar për të përgjithmonshmen (botën tjetër), shpërblimi i tij është në të përgjithmonshmen (botën tjetër).

Ata të cilët habiten me ta (pabesimtarët) dhe me civilizimin e tyre, thonë: U është dhënë kjo botë.

Mirëpo duhet të parashtrohet një pyetje tjetër: A i përket atij që beson në Zot, që të mirat e Allahut në prezencën e tij, t'ia usurpoj ai i cili e mohon Allahun?

Përgjigjja është: Jo! Xhelozia jonë për Allah na obligon që të themi: Duhet që besimtari të jetë i pari i cili i zbulon thesaret e Allahut, të cilat i ka fshehë në tokë dhe të veproj me to, dhe të mos lejoj që pabesimtari të triumfoj në diçka prej sekreteve të kësaj bote, sepse ndonjëherë pabesimtari triumfues me atë triumfin e tij bëhet i rrezikshëm dhe sprovë për fenë e besimtarit.

Kështu pra: Bota është dy llojesh:

Lloji i parë: reflekton te ti edhe nëse nuk e kërkon. Dielli të sjellë nxehtësi edhe nëse nuk kërkon. Drita të sjell dritën pa e kërkuar ti atë. Po ashtu edhe shiu bie pa e kërkuar. Të gjitha këto vijnë te ti pa i kërkuar.

Lloji i dytë: Të jep, nëse ti reflekton me të. Toka të thotë: Nëse ti vepron dhe mbjell dhe e kultivon, të jap.

Në cilin lloj njerëzit triumfojnë ndaj njëri-tjetrit?

Ata janë bashkëpjesëmarrës në atë e cila reflekton me ta. Dallohen dhe gradohen ndaj njëri-tjetrit në të. Një njeri është i fuqishëm sepse reflekton në diçka në të cilën tjetri nuk ka reflektuar. Nga kjo zhvillohet njeriu dhe me këtë arrihet ngritja (civilizimi) sepse tjetri vepron në atë që t'i nuk ke vepruar edhe pse nuk është kërkuar nga ti. Dielli të sjell ngrohtësinë dhe nxehtësinë, por nëse ti ngrihesh lartë me aktivitet, ajo të reflekton dhe të jep diçka tjetër, siç është rasti që prej diellit e fitojnë energjinë (solare) elektrike.

Sa i përket dobisë, sendet ndahen në tri lloje:

Lloji i parë: të jep edhe nëse nuk kërkon.

Lloji i dytë: të jep nëse vepron (reflekton) me të. Fuqia e njeriut është tek lloji i dytë.

Lloji i tretë: njeriu ngrihet në shkallë më të lartë nëse vepron me llojin i cili të jep edhe nëse nuk kërkohet prej saj.

Besimtari duhet ta dijë se aktiviteti i tij jetësor duhet të jetë në balancë me mjedisin ku jeton. Unë dal në mëngjes për të punuar për jetën time, dhe rezultatin e këtij angazhimit e quajmë *plotësimi i nevojave*. Duhet që të llogaris: Sa kam fituar? Sa kam harxhuar?

- Nëse harxhoj më shumë se sa fitoj, duhet ta dijë se më pret rreziku i shkatërrimit.

- Nëse shpenzoj aq sa fitoj, kjo është gjendje statike.

- Kurse, nëse fitoj më shumë se sa harxhoj, atëherë pritet që unë të zhvillohem.

Çdo ditë, besimtari duhet ta pyes veten e tij: Sa kam fituar? Sa janë nevojat e mia për sot? Tek atëherë ai e ndërton jetën e tij racionalisht.

Ta dish se, Zoti i Lartmadhëruar dëshiron nga aktiviteti yt të të bëj dobi ty dhe atyre rreth teje. Nuk kërkon vetëm nga ju aktivitet.

Nëse kërkon që ju të punoni me profesionalizëm për tjerët, atëherë të jesh i sigurt se pranë kësaj ka kërkuar që edhe tjerët të punojnë me profesionalizëm për ty.

Nëse ti i ke mashtruar njerëzit me punën tënde që e ke punuar për njerëzit. Allahu do të vendosë në zemrat e njerëzve që të të mashtrojnë me punët e tyre, që do ta punojnë për ty.

Ti ke mundësi t'i japësh vetes tënde pjesë prej çdo pjese të pjesëve të jetës tënde dhe të thuash: Unë këtë dhe atë e kam punuar me sinqeritet, me pesëdhjetë për qind të sinqeritetit, me njëzet e pesë për qind të sinqeritetit dhe në fund e shkruan, e pastaj e bën llogarinë se çka është marrë nga ju. Një pjesë ka shkuar për mjekun. Një pjesë për atë i cili te ka anashkaluar dhe te ka neglizhuar ty, dhe në fund e nxjerr rezultatin dhe e sheh se del barazim.

Ti e mashtrosh një njeri, ndërsa ty do të të mashtrojnë dhjetë. Mos tento të mashtrosh Zotin tënd. Çështja është që të mos injorosh se me këtë e ke injoruar veten tënde. Kush e lodh tjetrin e ka lodhur veten e tij dhe kësaj do t'i shtohet edhe pjesa tjetër, që të plotësohet ajo çka ke vepruar.

Kështu Allahu i ka vendosur ligjet në ekzistencë, me qëllim që të pengohet mashtrimi dhe zilia. Nëse e sheh ndonjë njeri se është më i aftë se ti për diçka, mos mendo se ai përfiton, dije se përfitojnë tjerët prej tij. A ke dëgjuar për shembullin e farkëtarit të guximshëm dhe berberit të shkëlqyer ku prej tyre përfitojnë njerëzit. Ndonjëherë nuk mund të gjesh berber i cili i rregullon flokët shkëlqyeshëm. Çdo dhunti e cila i jepet dikujt tjetër, ajo do të të shërbej edhe ty. Shembull: Dora e djathtë lëvizë më lehtë dhe e kontrollohet më mirë kur t'i ketë gërshërët për t'i prerë thonjtë e dorës së majtë dhe i prenë me precizitetin kulminant. Nëse i mban gërshërët me dorën e majtë, për t'i prerë thonjtë e gishtave të dorës së djathtë, nuk mund t'i presh me të njëjtin precizitet. Kështu pra, zakonisht dora e djathtë është më e aftë se dora e majtë. Kështu, nëse e sheh se një person ka një veti të veçantë, thuaj: Kjo veti do të jetë edhe në dobinë time dhe do të ruhem që kurrë të mos e dëmtojë.

Allahu dëshiron që aktiviteti jonë i jetës të shkoj me sinqeritet dhe kënaqësi. Ti nëse vepron një punë dhe për atë punë i frikohesh Allahut, Ai të thotë: Ti po e punon këtë punë, nga ti kërkohet që ta punosh me precizitet për dy arsye:

- arsyeja e parë është për klientin; dhe
- arsyeja e dytë është për Allahun.

Sa i përket klientit, është e mundur që ai të mos i sheh te metat dhe mangësitë e punës.

Sa i përket Allahut, Ai e percepton çdo gjë në imtësi.

Çdo kohë të punës për kënd e punon? Për Allah?! Nëse është kështu, atëherë ti punën e ke bërë për Allah dhe e ke paraparë se ai të përcjell dhe të inspekton ty, atëherë dije se ai i inspekton i përcjell dhe i percepton edhe punët e të tjerëve që punojnë për ty. Nëse ti e mashtron një person, do të të mashtrojnë ty njëmijë persona.

Vështroi njerëzit rreth teje dhe do të vëresh se gjithmonë kërkohet serioziteti dhe do të shohësh se ai i cili e di se gjithmonë e sheh Allahu dhe është i kujdesshëm, do t'i pranohen dhe do të ketë dobi prej Allahut, aq sa nuk mund ta imagjinosh. Ti befasohesh, por ndihma e Zotit është me të, begatia e Zotit është te ai, sepse ai ka punuar për Allah. Kështu që aktiviteti i besimtarit në këtë botë duhet të jetë i ndërlidhur me Allahun dhe Allahu ia cakton shpërblimin ashtu siç e sheh Ai me caktimin e Tij, ndërsa njeriu ta cakton shpërblimin në bazë të caktimit dhe kapacitetit të tij. Sikurse njeriu për njeriun është i nivelit të njëjtë, për këtë arsye çdo fëmijë me fëmijën dhe

çdo shok me shokun përkujdeset varësisht prej kapacitetit të tij, pra në masë të të njëjtit nivel.

Fati dhe fatkeqësia

Allahu dëshiron nga ne që t'i mbrojmë pjesët e trupit dhe të mos dëshpërohemi për atë që na kalon. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لَا تَأْسَوْا عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ ۚ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ﴿٢٣﴾

“Për arsye që të mos dëshpëroheni prej asaj që ju kalon dhe të mos gëzoheni për atë që ju ka dhënë.” (El Hadidë : 23)

Nëse më sillni një njeri i cili nuk pikëllohet nga ajo që i ka kaluar dhe që nuk krenohet me atë që i ka dhënë Allahu, atëherë do të them se ky njeri është i plotë, i qëndrueshëm dhe i shëndoshë. Prej asaj që ka kaluar nuk mund të merret asgjë.

E mira (në shikim të parë), tek e cila nuk arrihet dhe nuk merret asgjë prej saj, nuk mund të dihet se a është e mirë, sepse ajo çka ka në të nuk dihet a është e dëmshme apo e dobishme. Nëse kërkon pasuri dhe të jepet, ti nuk e di se a është e dëmshme apo e dobishme. Ajo e cila kalon, nuk kthehet. Ai i cili e humb shpresën, në këtë rast në bartjen e barrës së jetës, ai ka forcë më të dobët se ti. Kjo është fatkeqësi shtesë, për këtë arsye Allahu dëshiron që të të mësoj se ajo çka ka kaluar, ka marrë fund, mos e mendo më atë, sepse e dobëson fuqinë tënde të jetesës.

Në këtë mënyrë dhe me këtë program të jetesës, Allahu i orienton njerëzit që t'i kthehen drejt rrugës së jetës së tyre. Drejtimi në anën e jetës përpara është çështje natyrore, pasi që njeriu qëndron në gjendjen ekzistuese dhe i bashkëngjitet programit të drejtë në të cilin qëndron dhe lë pas vete programin jo të drejtë.

Kështu pra, ndodhia e aksidenteve është çështje normale dhe përderisa ndodhitë janë çështje natyrore, patjetër duhet të përgatitemi kundër atyre aksidenteve. Ndodhitë të cilat i ndodhin njeriut, janë çështje të domosdoshme. Përderisa njeriu është qenie lëvizëse dhe vepron me botën lëvizëse, duhet të qëndroj i vendosur në mesin e ndodhive.

Zoti thotë: Mos jeto në ngjarjen e cila është në kohën e kaluar të saj. Kur t'i kaloj koha ngjarjes, duhet ta përfundosh aktivitetin tënd me përfundimin e saj, pos nëse është në pyetje të përfitosh për të ardhmen prej asaj ngjarje, atëherë angazhohu me atë ngjarje, por nëse ajo ngjarje të demoralizon dhe të dobëson, ta dish se ti je ai i cili je duke e aktivizuar atë ngjarje nga e kaluara në të ardhmen, e kjo është e palogjikshme.

Duhet që veten tënde ta vendosësh në atë pozitë që gjërat të cilat vijnë tek ti të jenë të pranuar dhe t'i pranosh ato si begati prej Allahut. Bëhu falënderues dhe mos u gëzo me ato, sepse në vetvete begatia nuk është për tu gëzuar deri në momentin kur të përputhet në atë me çka është e paraparë.

Duhet ta dish se, begatia në vetvete nuk është për tu gëzuar. Ndonjëherë begatia të bën dëm, sepse të mashtron dhe të shpie në mëkate, sepse ndoshta, po të mos e kishe pasur atë pasuri, ti nuk do të kishe qenë i mashtruar për t'i bërë ato mëkate. Kështu pra, mos u dëshpëro për atë çka të kaluar dhe mos u gëzo me atë që je begatuar. Parashtrohet pyetja, pse?

Sepse nuk është e logjikshme të gëzohesh me diçka që të është dhënë, deri sa me atë që të është dhënë nuk e ke realizuar *objektivin* e duhur. E, objektivi i një sendi nuk është që vetëm ta disponosh (pronësosh) atë, por objektivi është që ta shfrytëzosh dhe ta shpenzosh në atë që është i kënaqur Allahu.

Mos u gëzo! Gëzimi duhet të afatizohet deri në kohën kur ta kuptosh përfundimin e begatisë për çka ta ka dhënë Allahu, pa marrë parasysh a është në pajtueshmëri me ty apo jo. Këtë çështje, pra funksionimin kësaj bote me të cilën realizohen shpresat dhe qëllimet na i sqaron Zoti i Lartmadhëruar kur thotë:

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾

“Dhe sa i përket njeriut, kur ta sprovon atë, e nderon dhe e begaton, thotë: Zoti im më nderoi.” (El Fexhr : 15)

Nga aspekti i jashtëm, kjo çështje është e pranuar, por kur thotë Zoti i Lartmadhëruar:

وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهْنَنِ ﴿١٦﴾

“Përderisa, Ne e sprovojmë atë, ia ngushtojmë (furnizimin) e jetës, thotë: Zoti im nuk më nderoi (më nënçmoi).” (El Fexhr : 16)

Edhe këtë e thotë njeriu!!.

Në bazë të logjikës së njeriut, a ka pasur Allahu të drejtë?.

Në rastin e parë a ka qenë e arsyeshme logjika e njeriut dhe,

A ka qenë e arsyeshme logjika e njeriut të rastit të dytë apo ka qenë gabim?.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Jo kurrsesi!.**

Në rastin e parë nuk është e logjikshme

Edhe në rastin e dytë nuk është e logjikshme dhe e drejtë.

Si mund të jetë kështu?

Begatia nuk është begati vetëm për ta disponuar atë begati, por duhet të gëzohesh me mënyrën (e drejtë) e shpenzimit të saj:

Nuk i nderoni jetimët?.

Përderisa nuk i nderon jetimët, o ti i cili ke begati (pasuri), begatia është kundër argument për ty. Ti ke hyrë në një provim të rëndë dhe ke ra prej atij provimi. Nuk është nderim vetëm pse të është dhënë pasuri, por begatia është në shpenzimin e drejtë te asaj begatie sepse vazhdon dhe thotë Zoti i Lartmadhëruar:

وَلَا تَحْضُونَّ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ ﴿١٨﴾ وَتَأْكُلُونَ التَّرَاثَ أَكْلًا لَّمَّا ﴿١٩﴾ وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا ﴿٢٠﴾

“Dhe nuk angazhoheni në ushqimin e të varfërve, e as nuk i keni nxitur të tjerët në ushqimin e të varfërve.

Dhe e hani pasurinë me ngrënie të pangopur. Dhe e dëshironi pasurinë, e doni atë marrëzisht.” (El Fexhr : 18, 19, 20)

Kështu pra, dhënia e begatisë a mos është nderim apo mjet nënçmimi.

Ndonjëherë është mjet nënçmimi, sepse ti je përfaqësua vetëm me pronësim të pasurisë dhe jo me dhënie të saj.

Zoti i ka kategorizua njerëzit në kategori të shumta: Të *urryerit* janë kategori, po ashtu edhe të *dashurit* janë kategori. (Në hadith Kudsij) Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“I dua tri kategori njerëzish, por tri kategori tjera i dua edhe më shumë:

- **E dua të pasurin fisnik, por të varfrin fisnik e dua edhe më shumë.**
- **E dua të varfrin e devotshëm, por të pasurin e devotshëm e dua edhe më shumë.** Kjo për shkak se te i pasuri janë elementet dhe shkaqet të cilat mund ta sjellin në kryelartësi.
- **E dua plakun e dëgjueshëm, por të riun e dëgjueshëm e dua edhe më shumë.** Elementet e mëkatimit janë më të theksuara te i riu, por ai nuk i shfrytëzon elemente për mëkat.

I urrej tri kategori njerëzish, por tri kategori tjera i urrej edhe më shumë:

- **E urrej të pasurin kryelartë, por të varfrin kryelartë e urrej edhe më shumë.**

- E urrej të varfrin koprrac, por të pasurin koprrac e urrej edhe më shumë.
- E urrej të riun mëkatar, por plakun mëkatar e urrej edhe më shumë.”

Nëse jeton në një shoqëri ku i pasuri është fisnik, i varfi i devotshëm dhe i riu i dëgjueshëm, ta dish se ajo shoqëri është ideale dhe me vlera. Kjo është begati. Kurse e kundërta e kësaj është shoqëria e pavlerë dhe e neveritshme, ku i varfri është kryelartë, i pasuri koprrac dhe i riu mëkatar.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

لَكَيْلًا تَأْسَوْا عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُوا بِمَا آتَاكُمْ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ﴿٢٣﴾

“Ashtu që të mos dëshpëroheni nga ajo që ju kalon dhe të mos krenoheni me atë që ju dhurohet.” (El Hadid : 23)

tregon për funksionimin e jetës. Kjo nënkupton që begatia ndonjëherë është sprovë për ty, nëse nuk e shfrytëzon në të drejt dhe ashtu siç e ka paraparë Allahu. E ajo begati atëherë bëhet argument kundër jush.

Nëse dëshpërohesh për atë që të kalon dhe që nuk e arrin, atëherë ti e ke angazhuar veten në diçka që është inekzistente.

Ne themi: Po pse nuk e angazhon veten në atë që e ke në kompetencë?.

Nëse e angazhon veten në atë që nuk ke kompetencë, atëherë e shpenzon energjinë në ngjarjen e së kaluarës dhe nuk ke më energji për të ardhmen. Keni kujdes, mos e ngarkoni veten me atë se aksidenti ta ka bërë jetën të plogësht dhe të ka dëshpëruar.

E vërteta është se pikëllimi dhe brenga vijnë nga diçka që është më e vonshme se aksidenti dhe fatkeqësia, por ti as nuk je duke e ditur burimin e atij pikëllimi dhe as nuk je duke pasur forcë për ta larguar atë.

Kjo është gjëja më e keqe në shpirtin e njeriut: Që njeriun ta sundoj diçka, së cilës nuk ia di prejardhjen apo burimin, ose ia di por nuk ka forcë që ta largojë. E ajo mërzi dhe pikëllim është lidhur fort në ty dhe ta ka zërë frymën.

Lumturia dhe Kryeneçësia

Caktimi për të qenë zëvendës në fytyrën e tokës është bërë që i zëvendësuari ta zhvillojë atë.

Nëse njeriu dëshiron që të përparoj dhe ta zhvillojë jetën e tij, ai duhet që të punoj me të gjithë forcën dhe me të gjitha mjetet të cilat i disponon, të cilat mjete i ka krijuar Allahu për të.

Nëse nuk vepron me aftësitë e tij, atëherë faji është te njeriu, i cili e ka marrë detyrën të jetë zëvendës dhe jo tek Ai i cili e ka caktuar zëvendës.

Zhvillimi i jetës njerëzore, kërkon që forca e krijuar të veprojë në materien e krijuar, në bazë të planifikimit të planifikuar nga Planifikuesi, e Ai planifikues është Allahu. Çdo pikësynim për të arritur deri te një vlerë (qoftë materiale, qoftë jomateriale), vlerësimin do ta gjej tek Allahu.

Mjetet materiale të jetës janë diçka, përderisa mjetet jomateriale siç janë vlerat shpirtërore të njeriut janë diçka tjetër.

Ndonjëherë njeriu i plotëson të gjitha nevojat materiale, mirëpo prapëseprapë ai vazhdon të jetoj me stres dhe brenga. Këtë po e dëshmon civilizimi bashkëkohor i cili ka arritur aq lartë, bile edhe të shkojë edhe në hënë.

Pas këtyre zbulimeve shkencore, njeriu ka qenë dashur të jetoj edhe më i lumtur, por ne nuk po e shohim një gjë të tillë, por të kundërtën.

Çdo herë kur ne po zbulojmë në gjithësi një sekret prej sekreteve të Allahut, shohim se me atë zbulim padëgjueshmëria po bëhet edhe më e madhe. Kështu pra, ne duhet të hulumtojmë ta gjejmë atë që na mungon. Logjikisht, është dashur që, sa herë që të zhvillohemi dhe të civilizohemi, më shumë të gjejmë lumturi edhe më të madhe.

Civilizimi dhe lumturia do të duhej të ngrihej në raport me zhvillimin, por ne, në përgjithësi po bëhemi më të pa lumtur dhe më të stresuar, bile stresi dhe pasiguria aq shumë është përhapur saqë nuk po mund të gjendet asnjë popull në tokë i cili nuk është prekur nga ky fenomen. Po të kishte qenë kjo te popujt e prapambetur dhe të pazhvilluar, do të kishim mundur ta arsyetojmë, por si t'i arsyetojmë popujt e zhvilluar dhe të fuqishëm. Por, kjo pasiguri, përveç popujve të fuqishëm, ka prekur edhe popujt e dobët, të cilët edhe pse janë më të sigurt dhe më të lumtur, prapë se prapë edhe siguria e tyre është e brishtë dhe tronditet herë pas here. E gjithë kjo dëshmon se në mesin e gjithë njerëzimit, ekziston një element i humbur.

Ai element na tregon se, bota, sado që të zhvillohet materialisht, atij i mungon elementi i humbur, e ai element është: Siguria ndaj stresit. Për këtë, Zoti i Lartmadhëruar na tregon për aftësinë dhe fuqinë e Tij dhe atë se njeriu nuk është i lënë në dorën e vëllait të tij njeri, dhe se njerëzit sado që të kenë liri të lëvizjes dhe të veprimit, ata prapëseprapë janë të gjykuar të veprojnë brenda kornizave të caktuara dhe tejet precize

Këtë Zoti i Lartmadhëruar e tregon me shembull, kur thotë:

قَالَ عِلْمُهَا عِنْدَ رَبِّي فِي كِتَابٍ لَا يَضِلُّ رَبِّي وَلَا يَنسَى ﴿٥٢﴾

“Në libër, Zotit tim nuk i humb asgjë, dhe as nuk harron.” (TaHa : 52)

Keni kujdes, mos mendoni se kjo (ky ajet) ka të bëjë vetëm për botën tjetër, por ajeti ka të bëjë edhe për këtë botë. Çdo njeri e ka regjistrin e vet, në të cilën shkruhet për të dhe kundër tij. Për këtë, njeriu, shumë herë e mashtron veten e tij kur mendon se të tjerët i harrojnë të bëmat e tij, edhe pse vet nuk i ka harruar, dhe kështoj merr çka nuk është e tij dhe thotë: “Kjo është racionale (të vjedhësh), kur nuk të shohin ata që janë më lartë se ti.” Por të jesh i sigurt se ti, kur të dish se e ke Inspektorin (Zotin) edhe më të lartë, i cili i regjistron edhe frymëmarrjet, lëvizjet dhe moslëvizjet nuk mashtron.

Dije se, nëse tenton të marrësh të drejtën e cila nuk të takon ty, ka për tu marrë e drejta në mënyra të ndryshme, pa e ditur ti, kjo bëhet që të nivelizohet me të padrejtën që ke synuar dhe që ke bërë ti.

Çdo njeri që shtrembëron gjërat në jetën e tij, atij do t’i shtrembërohen gjërat në të njëjtën masë të cilat i ka shtrembëruar ndaj tjetrit. Nuk mund të ndodh që një njeri të abuzoj me jetën e të tjerëve, e që Allahu të mos e bëjë një njeri tjetër që të abuzoj me të.

Nëse shikojmë historinë e të padrejtëve dhe kriminelëve do të shohim se veprat e tyre i kanë dërguar në devijim total. Me këtë shohim se, Allahu, drejtësinë e Tij nuk e vonon për botën tjetër.

Në atë masë sa është gruaja e kujdesshme në ruajtjen e nderit të saj, po në atë masë sillen njerëzit e tjerë me të. Në atë masë sa ajo e ruan veten nga shikimet, dhe e ruan bukurinë e saj nga tërheqja e njerëzve, po në atë masë Allahu e siguron atë prej shikimeve të tjerëve, dhe nuk lejon që të tjerët ta ngacmojnë atë, ashtu që njerëzit largohen nga ajo në distancë të paparamenduar. Nëse dikush do të kishte dashur ta shikoj vetëm një herë dhe nëse e sheh atë, ajo do ta pështynte atë në botën tjetër. Të gjitha këto

pohime mund të krahasohen në këtë botë. Ai i cili shikon drejtë në këtë botë, do të shihet plotë e përplot raste, e plot e përplot shembuj.

Nëse atij i cili ka bërë krime në këtë botë ia llogarisim dëmet që i ka bere dhe demet të cilat i kanë ndodhur, do të shohim se rezultati në mes dëmit që ka bërë dhe dëmit që i ka ndodhe, është i barabartë.

I dërguari i Allahut s.a.v.s. na ka tërhequr vërejtjen që të kemi kujdes në çështjen e funksionimit të jetës.

Sa i përket llogaritjes së fitimit, njerëzit ndahen në dy kategori:

- Një kategori e njerëzve dëshirojnë fitim të drejtë dhe angazhohen maksimalisht që të fitojnë për ta siguruar jetën në këtë botë,
- Një kategori tjetër dëshiron që të fitoj pa u lodhur ne kurriz të tjerëve, duke i sunduar të tjerët, duke ua marrë të drejtën dhe djersën e tyre.

Shikoni me vëmendje dhe dëgjoni çështjen të cilën do t'ua tregoj se çka ndodh në këtë botë. Pejgamberi s.a.v.s. nuk e tregon një çështje, e që pastaj të ndodh e kundërta e asaj siç e ka treguar, sepse kjo do të ishte sfide e madhe për pasuesit e tij, sepse njerëzit do të thoshin: Ka thënë pejgamberi i Allahut kështu, por ne nuk e kemi parë shenja se ajo çka ka thënë është ashtu. E tash, shikoni se çka ka thënë i dërguari i Allahut s.a.v.s. sa i përket bazës së funksionimit të jetës, e cila quhet fitim:

“Kush fiton pasuri pa djersë, do t'i shkon pasuria pa e parë.”

Kjo do të thotë se, ashtu do të rrjedhin gjërat, saqë ajo pasuri do të harxhohet në atë mënyrë, saqë do të sëmuret dhe tjetri për ta shëruar do t'ia merr atë pasuri që e ka fituar me pa të drejtë.

Allahu është Ai të cilin nuk e zë kotja e as gjumi, dhe është e pamundur që ta lë pas dore dhe të mos e marrë në llogari atë të cilin e ka krijuar të angazhohet. I thotë atij: Ti je marrë me angazhimin e krijesave. E Allahu do t'i hap dyert të cilat do Ai, që t'i merret atij ajo çka e ka marrë prej tjerëve. Për këtë arsye, këtë çështje, Allahu nuk e vonon për botën tjetër, sepse funksionimi i kësaj bote do të paralizohej nëse kjo çështje do të vonohej për botën tjetër dhe njerëzit nuk do të shihnin se si do të ballafaqohen njerëzit të cilët i kanë shfrytëzuar dhe i kanë keqpërdorur të dobëtit, e pastaj funksionimi i jetës do të ishte ne rrezik dhe do te shpartallohej.

Kështu pra, ai i cili mashtron, ka mashtruar veten e tij. Për këtë arsye, atyre të cilët mendojnë se kanë mashtruar Allahun, ne u themi atyre: Ti mashtron, Allahu të mashtron ty. Po ta bësh një krahasim të mashtrimit tënd,

me mashtrimin e Allahut, nuk do të kishte qenë e pamundur që Allahu t'i hapte dyert e të shpenzosh çka ke marrë prej atyre të cilëve u ke marrë pasurinë e cila nuk të takon ty.

Ky pra, është sistemi i jetës në këtë botë.

Një sistem tjetër e ka paraparë Allahu në këtë botë, e ajo është se besimi (imani) është siguri, e kjo nënkupton se: Çdo gjë e cila të ndodhë pa shkakun e veprës tënde, pa tjetër që ju duhet ta llogaritni se është mirësi dhe përderisa ti e llogarit se është e dobishme, ti nuk pikëllohes, dhe fuqia jote psikike nuk tronditet,

Sa i përket aspektit material, Zoti i Lartmadhëruar e ka paraparë që sistemi i jetës duhet të jetë sistem i mesatares, e ai sistem është:

وَكُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا تُسْرِفُوا إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ ﴿٣١﴾

“Hani dhe pini, por mos e teproni.” (El Earaf : 31)

Pjesën e ajetit “por mos e teproni” na e interpreton i dërguari i Allahut kur thotë:

“Ne jemi popull i cili nuk ha deri sa të uritet, e kur të ha nuk ngopet.”

A mund të ma sjellësh një njeri i cili nuk ha deri sa të uritet dhe kur të ha nuk ngopet, e pastaj të ndodh t'i shtrëngohet lukthi dhe t'i prishen të gjitha organet e brendshme të tij?. Jo! Kurrë!

Për shkak të mosngrënies së rregullt dhe ngrënies së tepërt, ne hasim dhimbje të llojeve të ndryshme të sëmundjeve fizike.

Sa i përket aspektit psikik, siç është çështja e funksionimit të mendjes dhe shpirtit, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Hani dhe pini, por mos e teproni.”

Nëse i bëjmë një analizë ekonomisë së jetës, ne do të shohim se për këtë, i dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka vendos rregullin:

“Nuk hamë deri sa të uritemi dhe kur të hamë nuk ngopemi.”

Ky rregull është parim themelor i ekonomisë. Sepse njeriu, kur të jetë i uritur, i mjafton çfarëdo lloji i ushqimit, përderisa ushqimet e shumta dhe të tepërta e shpijnë njeriun në stërngopje dhe e bëjnë të lodhur shpirtërisht dhe ndikojnë që ai të hajë pa kontroll dhe tej mase.

Ka dallim në mes të asaj që “ti ta shtysh veten të hash” dhe asaj “e cila e shtyn veten tënde të hajë”. Stabiliteti i jetës është në atë që “ti ta shtysh veten të hash”, në këtë mënyrë, çdo lloj ushqimi edhe qoftë i paktë, të

mjafton. Shumë mirë e ka thënë beduini: “Pjata më e shijshme është uria.” Uria e bën njeriun që të pëlqej çfarëdo ushqimi.

Parashtrohet pyetja: Çka është ajo që ndikon që mos ta duash ushqimin që të ofrohet?

Përgjigja është se: Epshi (nefsi) të thotë: Unë dua ushqim të këndshëm.

Praktikojë njëherë këtë: Shko në shtëpinë tënde kur të jesh i uritur. Në shtëpi ke gjeldeti të papjekur. Ti menjëherë do të shikosh mos ka mbetur diçka nga dita e mëparshme, e ha me oreks dhe të kënaq. Po pra! Kjo është e vërteta!. *Pjata më e shijshme është uria!*

Çka e sjell krizën ekonomike? Krizën ekonomike e sjell luksi dhe teprimi. Që epshi të dëshiron që të ha, e jo që unë t’i jap epshit të hajë. I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Nëse duhet që të ushqehesh, atëherë:

- një të tretën e lukthit mbushe me ushqim;

- një të tretën me ujë; dhe

- një të tretën leje për frymëmarrje.”

Çka është për frymëmarrje dhe çka nuk është për frymëmarrje.

Nëse e stërmbush lukthin, atëherë ndodhë një mbyllje në lukth. Ajo mbyllje i shtrëngon organet e frymëmarrjes dhe zvogëlohet frymëmarrja. Kjo nënkupton se shtrëngohen organet e frymëmarrjes dhe zvogëlohet normalizimi i funksionimit të tyre, që do të thotë, ajri i cili duhet të hyn në të nuk ka vend të mjaftueshëm. Kështu pra, kur Zoti i Lartmadhëruar e mëson të dërguarin e tij për diçka, nuk e lë pa ia mësuar edhe urtësinë e saj.

Kulminacioni i tolerancës islame

Si e trajtoi islami ateizmin?

Në kohën kur prezentoi islami, ekzistonin dy tabore:

1. Tabori i mosbesimtarëve në Zotin, pra tabori i cili besonte në materie (jo në Zot) dhe;
2. Tabori i pikëbashkimit të qiellit me tokën, me të cilin program për njerëzit kishte ardhur edhe i dërguari i Allahut s.a.v.s.

Feja islame ishte praktike me kohën në të cilën jetohej. E pranoi secilën ashtu siç ishte, e pranoi pabesimin vetëm se jo duke e ledhatuar por duke e kundërshtuar dhe akuzuar në të metën e pabesimit, sepse mospajtimi në mes të islamit dhe ateizmit ishte në thelbin e besimit, pra në ekzistencën e Zotit i cili e ka krijuar kozmosin.

Në anën tjetër u përball me të tjerët të cilët besonin në ekzistencën e Zotit dhe në zbritjen e shpalljeve qiellore për njerëzit, e ata ishin pasuesit e librit (ehlil kitab).

Parashtoret pra pyetja: **Si i trajtoi islami pasuesit e librit siç janë jehuditë dhe të krishterët?**

Islami i pranoi dhe i toleroi në tolerancën kulminante duke ju garantuar paqe dhe siguri. I përmendi cilësitë fisnike me të cilat i ka nderua Allahu të dy fetë me dy pejgamberët e tyre. E nderoi Musaun për mrekulli, po ashtu e nderoi Isaun. Sa i përket Isaut nuk e pranoi se ka lind si fëmijë prej prostitucioni dhe nuk i pranoi akuzat ndaj nënës së tij. Që të dy pejgamberët i pranoi duke u mbështet në parimin e bashkimit të qiellit me tokën.

Ne e dimë se persianët përfaqësonin zjarrputizmin dhe ateizmin, përderisa romakët përfaqësonin pasuesit e librit të cilët ishin më afër zemrës së të dërguarit të Allahut s.a.v.s dhe më afër zemrave të besimtarëve. Kjo nga shkaku se ishin pasues të librit. Kur ndodhi lufta në mes romakëve dhe persianëve u pikëllua i dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe së bashku me të dërguarin e Allahut u pikëlluan edhe besimtarët, sepse armiqësia në mes të ateistëve dhe muslimanëve ishte në shkallë më të lartë, përderisa në mes të muslimanëve dhe pjesëtarëve të dy feve tjera (krishtere dhe jehude) kishte pajtueshmëri sa i përket çështjes së Zotit, dhe sa i përket pikëbashkimit të qiellit me tokën dhe zbatimit të programit qiellor në tokë.

Kjo ishte arsyeja se pse zemra e të dërguarit të Allahut dhe zemra e besimtarëve ishin me pasuesit e librit. Për këtë arsye edhe ka zbritur Kur’ani që të tregoj se islami dhe logjika islame i ka dashur ata të cilët nuk e kanë besua Muhamedin (si Pejgamber) por që kanë besua në Zotin, dhe u ka dhënë përparësi këtyre ndaj atyre të cilët nuk kanë besua në Zotin.

Kështu pra, dashuria e Muhamedit s.a.v.s. ndaj Zotit të tij ishte më e fuqishme se sa dashuria ndaj vetes së tij. Pra, ata të cilët e kanë mohua Muhamedin a.s. kanë qenë më afër zemrës së Muhamedit se sa ata të cilët e kanë mohua Zotin. Nga ky shkak ishte pikëlluar i dërguari i Allahut s.a.v.s. kur mori lajmin se ka triumfua Persia ndaj Romakëve. Për këtë ngjarje kanë zbritur ajetet kur’anore:

غُلِبَتِ الرُّومُ ﴿٢﴾ فِي أَدْنَى الْأَرْضِ وَهُمْ مِنْ بَعْدِ غَلَبِهِمْ سَيَغْلِبُونَ ﴿٣﴾ فِي بَضْعِ سِنِينَ لِلَّهِ الْأَمْرُ مِنْ قَبْلُ وَمِنْ بَعْدُ وَيَوْمَئِذٍ يَفْرَحُ الْمُؤْمِنُونَ ﴿٤﴾

“Pësuan disfatë romakët, në tokën më të poshtme, mirëpo pas disfatës së tyre do të triumfoj, (kjo do të ndodhë) brenda disa viteve, sepse kjo është çështje e Zotit që e ka caktua edhe më herët edhe më vonë, dhe atëherë gëzohen besimtarët për ndihmën e Allahut.” (Err-Rrum: 2-4)

Kështu pra triumfi i pasuesve të librit ndaj atyre që mohojnë ekzistencën e Zotit duhet t’i gëzoj besimtarët të cilët besojnë në Zotin, sepse në esencë ne jemi besimtarë edhe pse nuk pajtohemi për të dërguarin i cili sjell shpalljen. Ato veç janë pajtua për Muhamedin në aspektin negativ (në mospranimin si pejgamber) por prapë se prapë zemrat e besimtarëve kanë anuar te ata, dhe janë me ata sepse Allahu i ka përgëzuar besimtarët se do t’ju ndihmoj besimtarëve edhe pse e mohojnë Muhamedin a.s. kur ka thënë: **“...Dhe atëherë do të gëzohen besimtarët me ndihmën e Allahut.” (err-Rrum : 4)**

A mos kemi dëgjuar ndonjëherë tolerancë më të madhe se kjo tolerancë?! Pra kur themi se gëzohen zemrat e besimtarëve në Muhamedin së bashku me zemrat e besimtarëve në Zotin edhe pse ata (pasuesit e librit) nuk e pranojnë Muhamedin.

Çështje tjetër: Si mundet t’i zbret ajeti fisnik të dërguarit të Allahut s.a.v.s. përderisa ka qenë pejgamber i cili nuk ka ditur shkrim dhe lexim dhe të gjykoj për luftën në mes të dy superfuqive më të mëdha të asaj kohe?. Superfuqisë së lindjes Persisë, dhe superfuqisë së perëndimit Romës. Si ka mundur me gjykua në përfundimin e luftës me triumfin e romakëve dhe atë brenda disa viteve. Kush është ai i cili mund të përcaktoj përfundimin e

luftës në mes të dy superfuqive dhe atë brenda disa viteve. Po të kishte gjykua vetëm për betejën ekzistuese, ne do të thoshim se Muhamedi s.a.v.s ka pasur njohuri dhe informacione për armatimin dhe forcën ushtarake të romakëve me të cilin armatim dhe forcë do të triumfonte ndaj Persisë, mirëpo përkufizimi brenda disa viteve është çështje serioze. Me të vërtetë është çështje serioze të gjykosh për fitoren e romakëve ndaj persianëve brenda disa viteve, pra prej shtatë deri në nëntë vite.

Si ka mundur të gjykoj përfundimin e një lufte ku në rend të parë nuk ka qenë pjesë e asaj lufte. Në rend të dytë ai nuk ka mundur me e ditur se brenda disa viteve cila do të forcohej dhe cila do të dobësohej, mirëpo e ka deklarua me vendosmëri dhe me siguri se Allahu do t'i ndihmoj romakëve brenda disa viteve, e atëherë do të gëzohen besimtarët për ndihmën e Allahut për fitore. Dhe me të vërtetë, brenda disa viteve u realizua fitorja... Kjo fitore ka ndodhur paralelisht me fitoren e muslimanëve në Bedr.

Parashtrohet një pyetje: A mos vallë pejgamberi s.a.v.s ka gjykua për çdo jehudi ashtu që të bëhet krahasimi me të. Jo, përkundrazi pejgamberi s.a.v.s e ka respektua gjendjen reale. Shumica e jehudëve posedon të drejtën dhe argumentin, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar na ka thënë neve:

﴿وَمِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ مَنْ إِنْ تَأْمَنَهُ بِقِنطَارٍ يُودِّعَ إِلَيْكَ وَمِنْهُمْ مَنْ إِنْ تَأْمَنَهُ بِدِينَارٍ لَا يُؤَدِّعُ إِلَيْكَ إِلَّا مَا دُمْتَ عَلَيْهِ قَائِمًا ۚ﴾

“Ka prej pasuesve të librit që nëse u besohet një thesar (pasuri), e zbatojnë. Dhe ka prej tyre që nëse u besohet qoftë edhe një dinarë nuk e zbatojnë vetëm nëse atyre u qëndron pranë.” (Ali Imran : 75)

Ajeti i ka barazua besimtarët me jehuditë ashtu siç i ka barazua besimtarët me të krishterët. Pse? Sepse po të ngrihej çdo jehud të gjykonte kundër tij dhe çdo i krishterë të gjykonte kundër tij, atëherë ata prej tyre të cilët i kanë përgatitur zemrat për të besua në Muhamedin s.a.v.s do të thonin: Pse të gjykoj (Muhamedi a.s) kështu për ne, kurse ne besojmë në të vërtetën. Muhamedi a.s. nuk i ka bërë padrejtësi asnjërit prej pasuesve të librit, por ka thënë: Ka prej tyre të cilët zbatojnë ligjet e Allahut dhe ka prej tyre të cilët nuk i zbatojnë ligjet e Allahut. Pra njësoj siç veprojnë besimtarët me Muhamedin a.s..

Për këtë arsye, pasuesit e librit duhet ta kuptojnë këtë çështje dhe energjinë e tyre mos ta bëjnë mbështetje të pabesimtarëve në Zotin sepse Allahu dëshiron nga ne që në tokë të mbizotëroj programi i tij dhe kur pasuesit e Islamit fitojnë në ndonjë vend prej vendeve të tokës ata sjellin

paqe, siguri dhe lumturi, sepse islami angazhohet për tolerancë dhe paqe dhe në realizim të programit të Zotit.

Kush i frikësohet Allahut, atij i frikësohet çdo gjë

Nëse Kur'ani paraqet diçka dhe nuk e konsideron të pavlefshme, do të thotë se pajtohet me atë. Për këtë arsye Belkisja ka thënë:

قَالَتْ إِنَّ الْمُلُوكَ إِذَا دَخَلُوا قَرْيَةً أَفْسَدُوهَا وَجَعَلُوا أَعِزَّةَ أَهْلِهَا أَذِلَّةً وَكَذَلِكَ يَفْعَلُونَ ﴿٣١﴾

“Vërtetë, kur mbretërit hyjnë në ndonjë vend, e shkatërrojnë atë, dhe personalitetet më të larta i zbresin në nivelin më të ulët” (En Neml : 34)

Kjo dëshmon se Kur'ani e përkrahte të vërtetën, qoftë edhe prej thënies së një femre, kur ajo veç e thotë të vërtetën. Belkisja ka thënë:

وَإِنِّي مُرْسِلَةٌ إِلَيْهِم بِهَدِيَّةٍ فَنَاطِرُهُ بِمَ يَرْجِعُ الْمُرْسَلُونَ ﴿٣٥﴾

“Dërgojani një dhuratë Sulejmanit.” (En Neml : 35)

Nëse ai, dhe administrata e tij dëshirojnë pasurinë atëherë jepuni pasuri.

I dërgohet Sulejmanit dhurata. Sulejmani ka qenë e kundërta nga ajo çka ka mendua Belkisja dhe (Sulejmani) ka thënë:

فَلَمَّا جَاءَ سُلَيْمَنَ قَالَ أَتُمِدُّونَ بِمَالٍ فَمَا آتَيْنَاهُ اللَّهُ خَيْرٌ مِّمَّا آتَيْنَاكُمْ بَلْ أَنْتُمْ بِهَدِيَّتِكُمْ تَفْرَحُونَ ﴿٣٦﴾

“Ju po më jepni pasuri, përderisa ajo çka më ka dhënë Allahu është më e mirë nga ajo që u ka dhënë juve. Me të vërtetë, ju me dhuratën e juaj po krekeni.” (En Neml : 36)

Nga ky çast Belkisja i është nënshtrua besimit. Këtu shihet mbizotërimi dhe thellësia e besimit. Çka ka thënë ajo? Mos ka thënë iu dorëzova Sulejmanit? Jo. Ajo ka thënë: **Jam dorëzuar së bashku me Sulejmanin**. Këtu paraqitet madhështia e besimit pasi që ajo ka thënë **“me Sulejmanin”** (e jo Sulejmanit), sepse dorëzimi është çështje tjetër, dorëzim Allahut Krijuesit të gjithë botëve.

Madhështia e Islamit është që të mos i dorëzohesh atij i cili është i barabartë me ty por t'i dorëzohesh Zotit të gjithë botëve.

Për këtë arsye, Kur'ani ka gjetur kohë që të paraqet shembuj të kësaj natyre. Ka paraqit edhe rastin kur Musau shkon te Firauni, dhe tek ai tubohen magjistarët.

Zoti i Lartëmadhëruar e ka përgatit Musaun ashtu siç e ka përgatit Ademin në Xhenet.

Kur Musa a.s. shkon te zjarri, në takimin e parë me Zotin e ka pasur Shkopin. Zoti e pyet:

وَمَا تِلْكَ يَمِينِكَ يَمُوسَى ﴿١٧﴾ قَالَ هِيَ عَصَايَ أَتَوَكَّؤُا عَلَيْهَا وَأُشُّ بِهَا عَلَى غَنَمِي وَلِيَ فِيهَا مَآرِبُ أُخْرَى ﴿١٨﴾

“Çfarë ke në dorën tënde të djathtë o Musa?

I përgjigjet (Musau): Është shkopi im, në të cilin mbështetem. E përmbledh bagëtinë me të dhe e përdori për çështje tjera.” (TaHa : 17, 18)

Parashtrohet pyetja: Pse vallë, a nuk e ka ditur Zoti çka ka dhe për atë arsye e ka pyetur?. Jo, përkundrazi. Zoti e ka ditur por i ka bërë pyetje të shoqërimit duke iu shmangur shprehjes së egër dhe të pahijshme. Zoti ka dashur të bisedoj në nivel të rangut të Musa a.s. sikurse kur ti shkon te shoku yt dhe e sheh se shoku yt është i mërzhitur dhe t’i dëshiron ta qetësosh dhe i thua: “Po çfarë ke në xhep shoku im?”

Në anën tjetër, ka mjaftua që përgjigja (e Musaut) të ishte e thjeshtë. “Është shkop.”. Por Musa a.s. ka dashur që të zgjas bisedën e shoqërimit mirëpo kur e ka pa se përgjigja do të ishte e shkurtër, ka vazhduar duke thënë se unë atë shkop e kam edhe për përdorim të nevojave të tjera.

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur t’i dëshmoj se ajo është njohuria e tij për shkopin dhe për çka i nevojitet. Sa i përket shkopit, ai tek Allahu ka mesazh tjetër:

قَالَ أَلَيْهَا يَمُوسَى ﴿١٩﴾ فَأَلْفَلْهَا فَإِذَا هِيَ حَيَّةٌ تَسْعَى ﴿٢٠﴾

“I tha: Hudhe atë (shkopin) o Musa. Dhe e gjuajti atë dhe ai u bë gjarpër i cili lëvizte.” (TaHa : 19, 20)

Logjikisht Musa ka qenë dashtë të trembej dhe të frikësohej, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë:

قَالَ خُذْهَا وَلَا تَخَفْ ۖ سَنُعِيدُهَا سِيرَتَهَا الْأُولَى ﴿٢١﴾

“Mos u frikëso se do ta kthejmë në natyrshmërinë e saj të parë.” (TaHa : 21)

Po të mos frikësohej Musa, ne do të thoshim se ka qenë magji. Vërejeni se ka dallim të madh në mes të magjisë së popullit të Firaunit dhe asaj me të cilën ka paraqit Musa:

فَأَوْجَسَ فِي نَفْسِهِ خِيفَةً مُوسَى ﴿٦٧﴾

“Dhe Musa ndjeu një frikë në vetvete.” (TaHa : 67)

Pra, shkopi i Musaut është shndërrua në gjarpër të vërtetë përderisa magjistarët nuk i kanë shndërrua litarët e tyre në gjarpër. Populli i Firaunit i ka hipnotizua sytë e njerëzve ndërsa mrekullia mbinatyrore e Musa a.s. ka qenë e vërtetë nga shkaku se prapë gjarpri është shndërrua në shkop të Musait përderisa magjistarët i kanë bërë vetëm sytë e njerëzve të shohin kinse kanë parë gjarpër.

Çka i shtyri magjistarët të besojnë? Ata janë bërë besimtarë sepse ata e kanë parë shkopin i cili është bërë gjarpër dhe nuk e kanë parë si shkop dhe e kanë parë se litarët e tyre vazhdonin të jenë litar. Për këtë arsye ata kanë thënë: “Kjo nuk është vepër nga Musa.”

Pasi pësuan disfatë prej Musaut a mos kanë thënë “Ne i besojmë Musaut.” Jo. Ata kanë thënë: “Ne besuam në Zot të Firaunit dhe të Musaut.”

Kjo është madhështia e islamit sepse ti nuk i dorëzohesh dhe nuk i nënshtrohesh të ngjashmit me ty dhe as unë të ngjashmit me mua, por unë dhe ti i nënshtrohemi Allahut, Krijuesit të gjithë botëve. Kështu asnjëri askujt nuk i bën padrejtësi por secili i nënshtrohet fjalës së Allahut.

Ata të cilët në jetën e tyre i ikin gjykimit të planprogramit të Allahut mundohen që tjerëve tua paraqesin planprogramin e tyre. Por edhe nëse kanë qëllim të mirë ne u themi atyre: “Ne dhe ju i drejtohem atij i cili është më i lartë se ne, pra çka ka të paqartë apo të keqe këtu.”. Kështu pra islami në të njëjtën kohë është edhe emër edhe cilësi. Kjo është specifika e umetit të Muhamedit s.a.v.s.

Islami ka edhe atribut tjetër. E ai është se çdo popull pas Muhamedit është vazhdimësi e mesazhit të Muhamedit s.a.v.s. Parashtrohet pyetja *përderisa pas tij nuk ka pejgamber (për ta) dhe as Libra, atëherë si të përcillet ai mesazh?* Patjetër duhet të dimë se programi është i ruajtur. Allahu nuk ka dashur asgjë tjetër përpos të kumtoj programin. Dijetarët janë bartës të programit ashtu siç kanë qenë pejgamberët e beni israilëve bartës të programit të tyre. Ne nuk dëshirojmë që tjerët të mendojnë se dijetar është vetëm ai i cili hyn në universitetin e Ez-herit, ka vënë çallmën dhe merret

me çështjen e Daves. Jo! Përkundrazi, çdo njeri i cili di një çështje të fesë dhe atë e kumton ai është i ditur për atë çështje. Për këtë arsye, Muhamedi a.s. ka thënë:

“Zoti e begatoftë njeriun i cili dëgjon thënien time, e mëson dhe e përcjell tek të tjerët. Ndoshta ai i cili e përcjell është më i mirë nga ai prej të cilit e ka pranuar.”

Përderisa ti e di një dispozitë prej dispozitave të Allahut ti je njohës i asaj diturie.

Këtu duhet të vërejmë një çështje të rëndësishme, islamin ta parashtrojmë si shkencë teorike dhe ta zbatojmë si teori shkencore. Me zbatimin e islamit si teori shkencore kemi për qëllim që të zbatohet edhe si teori shkencore edhe si sjellje edukative. Shembull: Nëse ne si popull privohemi që ta praktikojmë islamin si planprogram edukativ atëherë cili duhet të jetë qëndrimi ynë?. Qëndrimi ynë duhet të jetë që së paku të jemi popull për ta paraqitur se çka është islami. Që do të thotë ta paraqesim islamin si shkencë, deri sa Zoti i Lartmadhëruar të sjell një njeri i cili mbart mbi supet e tij mesazhin qiellor dhe thotë: “Islami është edhe shkencë, dhe ne dëshirojmë ta praktikojmë islamin si shkencë”. Nëse veprojmë kështu a mos do të thotë se ne nuk e kemi praktikua islamin, pra nëse e kemi përcjell islamin vetëm si shkencë?. Jo përkundrazi ne themi: Lëre këtë qiri të ndezur dhe ruajeni të mos fiket se ndoshta më pas do të vjen një njeri tjetër dhe e merr atë qiri dhe prej atij qiri u ndez zjarrin.

Kështu pra, populli i Egjiptit nëse nuk mund ta praktikoj islamin si planprogram dhe si edukatë, atëherë prej atij kërkohet që më të mirën që ia ka dhuruar atij që e ka Ez-herin që ta ruaj islamin si teori shkencore, derisa Zoti i Lartmadhëruar të jep leje që prej angazhimit të tij në të ardhmen të zbatohet islami në praktikë (pas asaj teorike). Keni kujdes mos thoni: Po çfarë dobie ka prej islamit nëse mbetet dhe manifestohet vetëm si shkencë teorike?. Ne themi: Jo, mësoni islamin si teori edhe pse nuk praktikohet, sepse pas kësaj islami do të zbatohet falë angazhimit tënd të cilin ti e ke përcjell. Nëse çdo njeri e praktikon islamin në bazë të asaj çka e ka në kompetencë, atëherë qeveritarët do të rrëzoheshin vetvetiu pa i rrëzuar islami.

Po ta kuptonin qeveritarët se populli e do programin islam dhe e zbaton në vetveten e tyre dhe se ata do të mbeteshin të izoluar nga populli edhe ata do të dëshironin që të jenë me popullin dhe të zbatojnë programin islam.

Detyrë e qeveritarëve është që popujt e tyre të ndihen të sigurt, të qetë dhe të lumtur dhe atëherë kur ta kuptojnë se popujt e tyre e duan me shpirt islam, dhe me shpirt e dëshirojnë programin e Allahut, atëherë qeveritarët do të zbritnin te populli i tyre dhe vet do ta zbatonin atë program.

Detyra e jonë në Egjipt është që të angazhohemi dhe të përpiqemi në praktikumin e islamit ose së paku ta realizojmë islam, si shkencë (teori). Ta pasqyrojmë besimin islam, t'i sqarojmë të vërtetat e Kur'anit dhe të sqarojmë se Zoti ka fshehur në Kur'an thesare të cilat thesare do të zbulohen derisa të ekzistojë njerëzimi, sepse deri më sot na janë shpalosur gjëra të cilat janë treguar në Kur'an, gjëra që njeriu as që ka mundur me i paramendua.

Tani, detyra jonë është që ta pasqyrojmë dhe ta prezantojmë islam si besim dhe adhurim, dhe siç e përmendëm më parë veprim dhe besim. Besimi është qetësimi i zemrës për një çështje deri në atë masë sa që nuk ka nevojë ajo çështje të debatohet përsëri, sepse nëse rifillon debati për atë çështje aty nuk ka besim, por është projekt i besimit.

Ka dallim në mes të besimit të çështjeve me bindje të thellë dhe besimit të çështjeve hipotetike. Nga ti kërkohet të besosh me bindje, sepse vetëm bindja e thellë e plotëson besimin. Asnjëherë nuk kërkohet që të besosh në një çështje konkrete. Për tu besuar çështja patjetër duhet të jetë çështje e padukshme. Përderisa besimi është çështje e padukshme, atëherë asaj duhet t'i bashkëngjitet forca e argumentit dhe kur pas paraqitjes së argumentit të qetësohet zemra, atëherë bëhet bindje. Bindja është shkallë-shkallë. Ndonjëherë është teori (dituri) shkencore (**ilmul jekijne**), ndonjëherë e vërtetë shkencore (**ajnul jekijn**), kjo kur ajo që thuhet shndërrohet në të prekshme dhe ndonjëherë kur bëhet bindje shkencore (**hakkul jekijn**).

Bindja e besimit kalon në këto 3 shkallë:

1. Teori shkencore (**ilmul jekijne**);
2. E vërtetë shkencore (**ajnul jekijne**) dhe;
3. Bindje shkencore, që do të thotë kur të bëhet konkrete (**hakkul jekijne**).

Këto shkallë ua kam ilustruar nxënësve të mi. Pasi që isha kthyer nga një vizitë në Indonezi. U kam thënë atyre: Çka mendoni nëse them se në Indonezi kam parë një mollë në madhësi të shalqirit, me ngjyrë dhe shije të portokallit dhe me erë të mollës?.

Kjo është **teori shkencore**, sepse ata besojnë në fjalën time pasi që unë jam mësuesi i tyre. Pastaj, kur ua kam sjellë në prani të tyre dhe e kanë pa atëherë është bërë e **vërtetë shkencore**. Përderisa kur e kam prerë atë mollë dhe secilit prej tyre ua kam dhënë nga një pjesë të asaj molle dhe secili prej tyre e ka shijuar atë, atëherë ka kalua në **bindje shkencore**. Kjo e fundit është shkalla më e lartë e bindjes.

Për këtë arsye kur ka pyetur Muhamedi a.s.: *Si u zgjove?*

Ai është përgjigjur: *Besimtar i vërtetë. E kam larguar veten nga kjo botë dhe kjo botë tek unë është bërë e barabartë me gurë. E ndiej veten para arshit të Zotit tim, dhe më bëhet sikur i shoh banorët e xhenetit duke përjetuar kënaqësi, dhe banorët e zjarrit duke u dënuar.*

Pastaj Muhamedi a.s. ka thënë: *E ke kuptuar, andaj përmbaju.*

Kjo pra, është e vërteta e bindjes së besimit ashtu siç na ka sqaruar i dërguari i Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar kur ka dashur të sqaroj këtë shkallë të bindjes ka zbritur ajetet:

أَلْهَكُمُ التَّكَاثُرُ ۚ حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ ۚ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ﴿٢﴾ ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ﴿٣﴾
كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ ﴿٤﴾ لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ ﴿٥﴾ ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ ﴿٦﴾ ثُمَّ
لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ ﴿٧﴾

“Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar (pasuri);

deri sa të shkoni në varre;

gjithsesi do ta merrni vesh;

madje së shpejti do të merrni vesh;

Kujdes! Ah sikur të dinit këtë të vërtetë shkencore (ilmel jekijne);

sigurisht do të shihni zjarrin flakërues;

pastaj me të vërtetë do ta vërtetoni atë të vërtetë me syrin tuaj saktësisht (ajnel jekijne);

pastaj, atë ditë do të pyesni veten për kënaqësinë e kësaj bote; (Et-Tekathur : 1-8)

Në këtë sure janë të përfshira vetëm dy shkallët e para.

Në Suretul Vakia na ka sqarua bindjen e së vërtetës (**Hakkul Jekijne**):

وَأَمَّا إِنْ كَانَ مِنَ الْمُكَذِّبِينَ الضَّالِّينَ ﴿٩٢﴾ فَنُزِّلْ مِنْ حَمِيمٍ ﴿٩٣﴾ وَتَصْلِيَهُ جَحِيمٍ ﴿٩٤﴾ إِنَّ هَذَا لَهُوَ حَقُّ الْيَقِينِ ﴿٩٥﴾ فَسَبِّحْ بِاسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ ﴿٩٦﴾

“por nëse ai (në agoni) është nga përgënjeshtuesit e humbur;

ai do të gostitet me ujë të valuar;

dhe do të përcëllohet në zjarrin e flakëruar (të xhehenemit);

padyshim, kjo është e vërteta e sigurt (Hakkul Jekijne);

andaj lavdëroje emrin e Zotit të Madhërishëm.” (El-Vakia : 92-96).

Pse te çështja e jobesimtarëve e ka përmendur bindjen e së vërtetës dhe nuk e ka përmendur këtë për besimtarët. Përgjigja është se besimtarëve u mjafton e vërteta e besimit (**ilmel jekijne**).

Për sa u përket jobesimtarëve, ata akuzojnë dhe nuk besojnë deri atëherë kur ta përjetojnë personalisht të vërtetën shkencore (**hakkul jekijne**).

PËRMBAJTJA

SEKRETI I BOTËS SË PADUKSHME.....	1
FATI DHE FATKEQËSIA	8
LUMTURIA DHE KRYENEÇËSIA	12
KULMINACIONI I TOLERANCËS ISLAME	17
KUSH I FRIKËSOHET ALLAHUT, ATIJ I FRIKËSOHET ÇDO GJË.....	21